



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 01, datë 12.12.2017

**PËR**

**NDRYSHIMIN E TRETË NË PLANIN KOMBËTAR SEKTORIAL  
PËR PROJEKTIN E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK (PROJEKTI TAP)**

Në mbështetje të neneve 5, 7, 17 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, të pikës 27.1, të nenit 27 dhe të pikës 6/1/b, nënndarja “iii”, e pjesës 1, të shtojcës 1, të Ligjit 116/2013, datë 15.04.2013 “Për ratifikimin e Marrëveshjes me Qeverinë e Vendit Pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, lidhur me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), si dhe të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave dhe Trans Adriatik Pipeline AG, në lidhje me projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP)”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 62, datë 27.01.2016 “Për miratimin e zbatimit të procedurës së thjeshtuar për ndryshimin e Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP), të miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 04.07.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP)”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e ndryshimit të tretë në Planin Kombëtar Sektorial për projektin e Gazsjellësit Trans Adriatik (Projekti TAP), miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 04.07.2013 të Këshillit Kombëtar të Territorit, të ndryshuar, përfshirë materialin grafik si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pikat 2, 3, 4 dhe 5 të Vendimit Nr. 1, datë 04.07.2013, të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (projekti TAP)”, të ndryshuar, ruajnë të njëjtën vlefshmëri edhe sipas këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
LEDIA TOTA

